Në C++, operatori _____ lexon nga një rrymë dhe operatori _____ shkruan në një rrymë.
>> <<

> <
<< >>
< >

Pyetja 116.

*ptr++ është ekuivalente me:

*ptr

ptr++

++*ptr

*(ptr++)

Pyetja 117.

Çfarë është shënjesi Null?

- A) Një shënjesi i cili nuk shënon asgjëkundi
- B) Një shënjesi që ka emrin Null
- C) Një shënjesi që ka vlerën 0
- D) Një shënjesi që ka vlerën -1

Pyetja 118.

eof() është funksioni që përdoret për :

- a) Vlerësimin e gabimeve në skedar
- b) Shtimin e të dhënave në skedar
- c) Kontrollimin e fundit të skedarit
- d) Vlerësimin e sasive të të dhënave

Pyetja 119.

Është dhënë struktura e mëposhtme

```
struct kafshe
```

```
{
```

```
bool gjitar;
```

```
string banesa;
```

```
int jetegjatesia;
```

```
};
```

```
kafshe macja;
```

Tregoni cila nga instruksionet e mëposhtme inicializon në mënyrë korrekte variablin macja?

- A) gjitar=true;
banesa="shtepi";
jetegjatesia=12;
- B) macja.gjitar=true;
macja.banesa="shtepi";
macja.jetegjatesia=12;
- C) kafshe.macja.gjitar=true;
kafshe.macja.banesa="shtepi";
kafshe.macja.jetegjatesia=12;
- D) kafshe.gjitar=true;
kafshe.banesa="shtepi";
kafshe.jetegjatesia=12;

Pyetja 120.

Është dhënë segment kodi i mëposhtëm. Tregoni për çfarë funksioni mund të shërbejë:

```
int x=10;
int y=2;
int mbetja=0;
while(y!=0)
{
mbetja=x%y;
x=y;
y=mbetja;
}
```

- A) për të llogaritur maksimumin ndërmjet dy numrave x dhe y
- B) për të gjetur mbetjen pasi pjestohet x me y
- C) për të gjetur pjesëtesin më të madh të përbashkët
- D) për të gjetur shumëfishin më të vogël të përbashkët

Pyetja 121.

Është dhënë funksioni :

```
void changeX()
{
static int x=3;
x=x*2;
cout << x << endl;
}
```

Në qoftë se ky funksion thërritet 3 herë nga funksioni main, tregoni se çfarë do të shfaqet:

- A) 6
12
24
- B) 6
6
6
- C) 24
24
24
- D) 3
3
3

Pyetja 122.

Në instruksionet e mëposhtme tregoni çfarë është a1:

```
typedef int *ptr;
ptr a1;
```

- A) Numër i plotë
- B) Gabim në deklarim
- C) Gabim në ekzekutim
- D) Shenjues në numër të plotë

Pyetja 123.

Tregoni se çfarë do të afishohet pas kompilimit dhe ekzekutimit të programit të mëposhtëm:

```
#include<stdio.h>
int main(){
    int x=2,y=4;
    if(x=y )
        printf("True");
    else
        printf("False");
    return 0;
}
```

- A) True
- B) False
- C) Gabim kompilimi
- D) Gabim ekzekutimi

Pyetja 124.

Tregoni se çfarë do të afishohet pas kompilimit dhe ekzekutimit të programit të mëposhtëm:

```
#include<stdio.h>
int main(){
    int x=2,y=4;
    if(x==2 || y==x )
        printf("True");
    else
        printf("False");
    return 0;
}
```

- A) True
- B) False
- C) Gabim kompilimi
- D) Gabim ekzekutimi

Pyetja 125.

Tabelat dydimensionale quhen ndryshe dhe:

- A) Tabela
- B) Matrica
- C) Vektorë
- D) Struktura

Pyetja 126.

Tregoni se çfarë afishon programi i mëposhtëm:

```
#include<stdio.h>
#include<math.h>
int main()
{
    int x=2,y;
    y=pow(++x,2)+pow(x++,2)+pow(x++,2);
}
```

```
printf("%d",y);  
return 0;  
}
```

- A) 16
- B) 27
- C) 34
- D) 42

Pyetja 127.

Është dhënë instruksioni:

```
a=getchar();
```

Cili është deklarimi i duhur për variablin c?

- A) char * a;
- B) int a;
- C) char a;
- D) unsigned int a;

Pyetja 128.

Është dhënë deklarimi dhe inicializimi char txt[25]="Programming C\0". Sa është gjatësia e këtij stringu?

- A) 13
- B) 15
- C) 20
- D) 25

Pyetja 129.

Tregoni se çfarë afishohet pas ekzekutimit të kodit të mëposhtëm:

```
char *p;
```

```
p="Gjuha C";
```

```
printf("%s",&p);
```

- A) G
- B) C
- C) Gjuha
- D) Gjuha C

Pyetja 130.

Tregoni se çfarë afishohet pas ekzekutimit të kodit të mëposhtëm:

```
int x,y=5;
```

```
x=y++,2,++y;
```

```
printf("%d %d",x,y);
```

- A) 2 2
- B) 5 5
- C) 5 7
- D) 5 9

Pyetja 131.

Tregoni cili nga funksionet e mëposhtme përdoret për të gjetur vendndodhjen e parë të një stringu në një string tjetër.

- A) strchr()
- B) strchr()
- C) strstr()
- D) strspn()

Pyetja 132.

Tregoni se cili nga aksesuesit specifikë të mëposhtëm nuk përdoret në C++:

- A) public
- B) external
- C) private
- D) protected

Pyetja 133.

Cila nga relacionet e mëposhtme njihet si relacioni i trashëgimisë?

- A) ka një
- B) pjesë e
- C) ka lidhje me
- D) është një

Pyetja 134)V1

Cili nga operatorët logjik është operatori logjik dhe (AND):

- A) &&
- B) &
- C) |
- D) ||

Pyetja 135)V1

Cili nga operatorët logjik është operatori logjik ose (OR):

- A) &&
- B) &
- C) |
- D) ||

Pyetja 136.

Tregoni se çfarë afishohet pas ekzekutimit të kodit të mëposhtëm:

```
char str[20]="muri";  
char *const s=str;  
*s='g';  
printf("%s",str);
```

- A) m
- B) g
- C) muri
- D) guri

Pyetja 137.

Është dhënë përcaktimi i funksionit:

```
void swap(int &x,int &y)
{   return; }
```

dhe segmenti i mëposhtëm në funksionin main:

```
int x=3;
int y=5;
swap(x,y);
cout << x << ' ' << y << endl;
```

Tregoni se çfarë do të afishohet.

- A) 3 5
- B) 5 3
- C) 0 0
- D) 3 0

Pyetja 138.

Janë dhënë instruksionet e mëposhtme:

```
int x=5;
if(x==5)
    cout << "True";
else
    cout << "False";
```

Tregoni çfarë afishohet:

- A) True
- B) False
- C) TrueFalse
- D) Null

Pyetja 139.

Tregoni çfarë afishohet pas ekzekutimit të instruksioneve të mëposhtme:

```
int x=0;
for(x=0; x<10; x++) {}
cout << x;
```

- A) 10
- B) 9
- C) 0
- D) 1

Pyetja 140.

Nëse variabli nota ka vlerë 65 çfarë do të afishojë segmenti i mëposhtëm:

```
if (nota >= 45)
    cout << "Kalon";
else
    cout << "Nuk kalon";
```

- A) Kalon
- B) Nuk Kalon

- C) Kalon Nuk kalon
- D) Gabim kompilimi

Pyetja 141.

Një variabël i painingualizuar përmban:

- A) Nuk përmban asnjë vlerë.
- B) Vlerën e fundit të ruajtur në atë memorje që i rezervohet variablit
- C) Përmban vlerën 0.
- D) Përmban një vlerë random të gjeneruar nëpërmjet një funksioni.

Pyetja 142.

Prototipi i funksionit:

```
double ngreNëKub(double x);
```

- A) Deklaron një funksion të quajtur double që llogarit një numër në fuqi të tretë.
- B) Deklaron një funksion të quajtur ngreNëKub që merr si argument një double
- C) Deklaron një funksion të quajtur double që merr si argument një double dhe kthen një double.
- D) Deklaron një funksion të quajtur ngreNëKub që merr si argument një double dhe kthen një double

Pyetja 143.

Cila nga deklaratat e mëposhtme rreth tabelave nuk është e vërtetë:

- A) Një grup i njëpasnjëshëm vendodhje memorjesh.
- B) Elementet e saj mund të jenë të tipeve të ndryshme.
- C) E indeksuar nëpërmjet numrave të plotë.
- D) Deklarohet duke përdorur [].

Pyetja 144.

Është dhënë përcaktimi i strukturës:

```
struct Nyje {  
int data;  
Nyje *pas;  
};
```

Tregoni se çfarë bën funksioni i mëposhtëm

```
void gjejFunksion ( struct Nyje **q, int n )
```

```
{  
struct Nyje *temp ;  
temp = malloc ( sizeof ( struct Nyje ) ) ;  
temp -> data = num ;  
temp -> pas = *q ;  
*q = temp ;  
}
```

- A) Shton një Nyje në fillim të listës
- B) Shton një Nyje në fund të listës
- C) Shton një Nyje para nyjes me vlerë sa argumenti n
- D) Shton një Nyje pas nyjes me vlerë sa argumenti n

Pyetja 145.

Është dhënë përcaktimi i strukturës:

```
struct Nyje {  
int data;  
Nyje *pas;  
};
```

Tregoni se çfarë bën funksioni i mëposhtëm

```
void gjejFunksion(struct Nyje *q)
```

```
{  
struct Nyje *temp;  
temp=*q;  
*q=temp->pas;  
free(temp);  
}
```

- A) Fshin nyjen në fillim të listës
- B) Fshin nyjen në fillim të listës
- C) Fshin nyjen në mes të listës
- D) Fshin të gjitha nyjet e listës

Pyetja 146.

Është dhënë përcaktimi i strukturës:

```
struct Nyje {  
int data;  
Nyje *pas;  
};
```

Tregoni se çfarë bën funksioni i mëposhtëm:

```
Nyje* gjejFunksion( Nyje ** List )
```

```
{  
Nyje *temp1 = *List;  
Nyje * temp2 = NULL;  
Nyje * temp3 = NULL;  
while ( temp1 )  
{  
*List = temp1;  
temp2= temp1->pas;  
temp1->pas = temp3;  
temp3 = temp1;  
temp1 = temp2;  
}  
return *List;  
}
```

- A) Kthen një listë në të cilën ka ndryshuar vendin e nyjes së parë me nyjen e dytë
- B) Kthen një listë në të cilën ka ndryshuar vendin e nyjes së parafundit me nyjen e fundit
- C) Kthen një listë me elementet e listës së parë të kthyer mbrapsht
- D) Kthen një listë në të cilën ka fshirë nga lista në mënyrë të alternuar nyjet

Pyetja 147.

Është dhënë përcaktimi i strukturës:

```
struct Nyje {
```

```

int data;
Nyje *pas;
};
Tregoni se çfarë bën funksioni i mëposhtëm
int gjejFunksion ( Nyje *fillimi )
{
    if (fillimi== NULL)
        return 0;
    else
        return 1+ gjejFunksion (fillimi ->pas);
}

```

- A) Kthen vlerën 0
- B) Llogarit numrin e nyjeve
- C) Kthen numrin e nyjeve në pozicione çift
- D) Kthen numrin e nyjeve në pozicione tek

Pyetja 148.

Cili funksion print thërritet në kodin e vendosur në funksionin main?

```

class Person
{
    public:
        void print() ;
};
class Student : public Person
{
    public:
        void print() ;
};
int main()
{
    Person* x = new Student() ;
    x->print() ;
    return 0 ;
}

```

- A) Student::print()
- B) Person::print()
- C) Void print()
- D) Gabim në ekzekutim

Pyetja 149.

Cili funksion print thërritet në kodin e vendosur në funksionin main?

```

class Person
{
    public:
        virtual void print() ;
};
class Student : public Person
{
    public:

```

```

    void print() ;
};
int main()
{
    Person* x = new Student() ;
    x->print() ;
    return 0 ;
}

```

A) Student::print()
 B) Person::print()
 C) Void print()
 D) Gabim në ekzekutim

Pyetja 150.

Sa është vlera e variablit count pas ekzekutimit të segment kodit të mëposhtëm:

```
char a[] = "Gjuha C eshte gjuhe programimi e nivelit te larte";
```

```
char* p = a;
```

```
int count = 0;
```

```
while (*p != '\0')
```

```
{
```

```
    count++;
```

```
    while(*p != ' ' && *p != '\0') p++;
```

```
    while (*p == ' ') p++;
```

```
}
```

- A) 49
 B) 50
 C) 19
 D) 9

STRUKTURA TË DHËNASH

Pyetja 1.

Qëllimi i mënyrës “w+b” në operacionet me skedarë është:

- A) të krijojë një skedar binar për shkrim
 B) të krijojë një skedar binar për lexim ose shkrim
 C) të hapë një skedar binar për shkrim
 D) të hapë një skedar binar për lexim ose shkrim

Pyetja 2.

Cili nga operacionet e mëposhtme mund të ekzekutohen në skedarin “Notes.txt” pasi përdoret kodi i mëposhtëm?

```
FILE *fp;
```

```
fp=fopen(“Notes.txt”, “r+”);
```

- A) Lexim
 B) Shkrim
 C) Shtim në fund
 D) Lexim dhe shkrim

Pyetja 3.

Cili është qëllim i “rb” në funksionin fopen() të përdorur në instruksionet e mëposhtme:

```
FILE *fp;
```

```
Fp=fopen(“test.txt”, “rb”);
```

- A) Të hapë skedarin “test.txt” në mënyrë binare për lexim
- B) Të hapë skedarin “test.txt” në mënyrë binare për lexim dhe shkrim
- C) Të krijojë një skedar të ri “test.txt” për lexim dhe shkrim
- D) Të hapë skedarin “test.txt” për lexim dhe shkrim

Pyetja 4.

Tregoni se ku shënon fp në programin e mëposhtëm:

```
#include<stdio.h>
```

```
int main()
```

```
{ FILE *fp;
```

```
  fp=fopen("trial", "r");
```

```
  return 0;
```

```
}
```

- A) Karakterin e parë në skedar
- B) Një strukturë që përmban një shënjes të tipit char i cili shënon në karakterin e parë në skedar
- C) Emrin e skedarit
- D) Karakterin e fundit në skedar

Pyetja 5.

Pesë elemente A, B, C, D dhe E vendosen në një stivë njëri pas tjetrit duke filluar nga A. Nga stiva hiqet për katër herë rresht elementët të cilët vendosen në një rradhë. Më pas dy elementë fshihen nga rradha dhe shtyhen në stivë. Më pas një element hiqet nga rradha. Ky element është:

- A) A
- B) B
- C) C
- D) D
- E) E

Pyetja 6.

Si dallohet që një listë e lidhur është bosh?

- A) Shënjesi i kokës është i barabartë me 0.
- B) Shënjesi korrent është i barabartë me null.
- C) Shënjesi i kokës është i barabartë me null.
- D) Nyja që ndodhet pas shënjesit të kokës është e barabartë me null.

Pyetja 7.

Cila nga strukturat e të dhënave ruan elemente homogjene të dhënash?

- A) Tabelat
- B) Shënjesat
- C) Strukturat

D) Unionet

Pyetja 8.

Termi shtyj(“push”) dhe nxjerr(“pop”) kanë lidhje:

- A) Tabelat
- B) Listat
- C) Stivat
- D) Strukturat

Pyetja 9.

Një strukturë të dhënash elementet e të cilës mund të hiqen nga kreu dhe shtohet nga bishti por jo në mes është:

- A) Listë e lidhur
- B) Stivë
- C) Rradhë
- D) Pemë

Pyetja 10.

Një strukturë të dhënash elementet e të cilës mund të shtohen dhe hiqen nga kreu por jo në mes është:

- A) Listë e lidhur
- B) Stivë
- C) Rradhë
- D) Pemë

Pyetja 11.

Tregoni se çfarë afishon programi i mëposhtëm:

```
#include<iostream>
#include<conio.h>
using namespace std;
int sasia=0,N=11;
int main(){
    while(N!=0)
    {sasia++;
      N=N&(N-1);
    }
    cout << sasia;
    getch();
    return 0;
}
```

- A) 2
- B) 3
- C) 4
- D) 5

Pyetja 12.

Cili nga instruksionet e mëposhtme deklaron në mënyrë korrekte një tabelë?

- A) int tabela;
- B) tabela{5};
- C) array tabela[5];
- D) int tabela[5];

Pyetja 13.

Cili është indeksi i elementit të fundit të një tabele me 20 elementë?

- A) 18
- B) 19
- C) 20
- D) 0

Pyetja 14.

Cili nga instruksionet e mëposhtme akseson elementin e pestë të ruajtur në tabelën me 20 elementë të quatur tabela:

- A) tabela[4];
- B) tabela[5];
- C) tabela(5);
- D) tabela(4);

Pyetja 15.

Cila nga instruksionet e mëposhtme jep adresën e memorjes të elementit të parë në tabelën t me 10 elementë?

- A) t[0]
- B) t
- C) &t
- D) t[-1]

Pyetja 16.

Cila nga të mëposhtmet nuk është një strukturë të dhënash dinamike?

- A) Listë e lidhur
- B) Stivë
- C) Rradhë
- D) Tabelë

Pyetja 17.

Listat e lidhura lejojnë:

- A) Futjen dhe heqjen e lementeve kudo.
- B) Futjen dhe heqjen e elementeve nga kreu.
- C) Futjen e elementeve nga bishti dhe heqjen nga kreu.
- D) Futjen dhe heqjen e elementeve vetëm nga njëra anë.

Pyetja 18.

Cila nga deklaratat e mëposhtme nuk është e vërtetë rrëth stivave?

- A) Stivat mund të implementohen më lista të lidhura.
- B) Stivat mund të implementohen më tabela.
- C) Stivat janë struktura të dhënash të tipit FIFO(e para që futet e para del).
- D) Nyjet e reja mund të shtohen vetëm në majë të stivës.

Pyetja 19.

Nëse bajti i parë i një tabele ruhet në qelizën me adresë x, bajti i k-të ruhet në adresën:

- A) k
- B) x+k
- C) x+k-1
- D) x*k

Pyetja 20.

Cila nga të mëposhtmet përcakton në mënyrë të saktë një rregjistrim(strukturë)?

- A) struct {int a;}
- B) struct s {int a;}
- C) struct {int a;}s;
- D) struct s int a;

Pyetja 21.

Kur krijohet një strukturë përdoret fjala kyçe:

- A) structure
- B) struct
- C) record
- D) vector

Pyetja 22.

Është dhënë struktura:

```
struct tnode { char *word;
               struct tnode *left, *right;
               };
```

```
typedef struct tnode TREENODE, *TREEPTR;
```

```
TREEPTR tree;
```

```
TREENODE node;
```

Tregoni se cila nga shprehjet e mëposhtme është legale.

- A) node->word[2]
- B) node.word[2]
- C) tree->left->word
- D) *(tree->left)

Pyetja 23.

Cili princip është më i përshtashm për futjen dhe nxjerrjen e elementeve në një radhë?

- A) I pari futet i fundit shërbehet(FILO)
- B) I pari futet i pari shërbehet(FIFO)

- C) I fundit futet i fundit shërbehet(LILO)
- D) I fundit futet i pari shërbehet (LIFO)

Pyetja 24.

Cila nga strukturat e të dhënave përdoret për të realizuar rekursivitetin?

- A) Stiva
- B) Rradha
- C) Tabela
- D) Struktura

Pyetja 25.

Supozoni se është dhënë `int mat[][3]= {{1, 2}, {3, 4}, {5, 6}}`, sa është vlera e `mat[2][1]` ;?

- A) 3
- B) 4
- C) 5
- D) 6

Pyetja 26.

Cila është vlera e indeksit për elementin e parë të një tablele njëdimensionale?

- A) -1
- B) 0
- C) 1
- D) 2

Pyetja 27.

Cila nga deklaratimet e mëposhtme është deklarata valide për një shënjes(pointer)?

- A) `int * ptr;`
- B) `int ptr;`
- C) `int &ptr;`
- D) `pointer ptr;`

Pyetja 28.

Cili nga operacionet e mëposhtme nuk është operacion bazik që kryhet mbi një rradhë?

- A) Futja e një elementi në fund të radhës
- B) Futja e një elementi në një pozicion çfarëdo
- C) Aksesimi i një elementit nga kreu i radhës
- D) Heqja e një elementi nga kreu i radhës

Pyetja 29.

Gjeni funksionin anëtar që nuk gjendet në një klasë Stivë.

- A) `push()`
- B) `pop()`
- C) `back()`
- D) `top()`

Pyetja 30.

Gjeni çfarë afishohet pas ekzekutimit të programit të mëposhtëm:

```
#include<stdio.h>
int main()
{
    fprintf(stdout,"Pershendetje");
    return 0;
}
```

- A) Pershendetje
- B) Gabim kompilimi
- C) NULL
- D) Stdout

Pyetja 31.

Është dhënë struktura e mëposhtme:

```
typedef struct nyje
{
    int data;
    struct nyje *pas;
}liste;
```

Tregoni se çfarë bën funksioni i mëposhtëm:

```
void test(liste *kru)
{
    if(kru == NULL)
        return;
    test (kru ->pas);
    printf("%d ", kru->data);
}
```

- A) Printon nyje të alternuara
- B) Printon listën mbrapsht
- C) Shkakton gabim kompilimi
- D) Afishon listën e lidhur

Pyetja 32.

Është dhënë struktura e mëposhtme:

```
typedef struct nyje
{
    int data;
    struct nyje *pas;
}liste;
```

Tregoni se çfarë bën funksioni i mëposhtëm:

```
void test(liste *kru)
{
    if(kru == NULL)
        return;
    printf("%d", kru->data);
}
```

```

if(kreu ->pas!=NULL)
test (kreu ->pas->pas);
printf("%d ", kreu->data);
}

```

- A) Printon nyje të alternuara
- B) Printon listën mbrapsht
- C) Shkakton gabim kompilimi
- D) Afishon listën e lidhur

Pyetja 33.

Është dhënë funksioni i mëposhtëm:

```

void gjej()
{
    char c;
    if ((c = getchar()) != '\n') {
        gjej();
        putchar(c);
    }
    return;
}

```

Tregoni çfarë do të afishojë pasi përdoruesi të fusë nga tastjera stringun rekursiv.

- A) rekursiv
- B) visruker
- C) rvrsikue
- D) kursivre

Pyetja 34.

_____ është organizim i të dhënave për ruajtjen e tyre.

- A) Skedarë
- B) Tabela
- C) Lista të lidhura
- D) Struktura të dhënash

Pyetja 35.

Është dhënë tabela `int tab[]={1,2,3,4}`. Gjeni sa është vlera e elementit të ndodhur në `tab[3]`.

- A) 1
- B) 2
- C) 3
- D) 4

Pyetja 36.

Një numër i plotë zë 4 byte memorjeje, ndërsa një karakter 1 byte. Gjeni sa byte do të okupojë struktura e mëposhtme:

```

struct studenti
{int mosha;
char emri[20];
};

```

- A) 20
- B) 24
- C) 28
- D) 32

Pyetja 37.

Variabli i një shënjesi në një listë të lidhur mban adresën e :

- A) Nyjes korrente
- B) Nyjes së parë të listës
- C) Nyjes pasardhëse në listë
- D) Nyjes së fundit në listë

Pyetja 38.

Një strukturë të dhënash grupon së bashku:

- A) Elemente të të njëjtit tip
- B) Elemente të dhënash që kanë lidhje me njëra tjetrën
- C) Tipe të dhënash të përcaktuara nga përdoruesi
- D) Numra të plotë dhe stringje

Pyetja 39.

Listat e lidhura implementohen nëpërmjet:

- A) Strukturave
- B) Tabelave
- C) Radhëve
- D) Unioneve

Pyetja 40.

Tregoni se për cilin nga problemet e mëposhtme është e justifikueshme përdorimi i listave të lidhura:

- A) Shtimi i dy karaktereve
- B) Bashkimi i dy stringjeve
- C) Paraqitja një polinomi
- D) Shtimi i dy numrave të vegjël

Pyetja 41.

Tregoni se cili është avantazhi i listave të lidhura ndaj tabelave:

- A) Listat e lidhura okupojnë më pak memorje
- B) Listat e lidhura mund të ruhen në disk
- C) Listat e lidhura mirëmbahen më lehtë
- D) Fshirja e nyjeve është më e lehtë se në tabela

Pyetja 42.

Tregoni se çfarë afishon kodi i mëposhtëm:

```
int a[10]={1,2,3};  
printf("%d",a[3]+a[4]);
```

- A) 0
- B) 3
- C) 5
- D) 6

Pyetja 43.

Janë dhënë instruksionet e mëposhtme. Tregoni sa do të jetë vlera e a, b dhe *ptr pas ekzekutimit të këtyre instruksioneve:

```
int a, b, *ptr;
ptr=&a;
a=9;
b=*ptr;
a++;
```

- A) 5 5 5
- B) 6 5 6
- C) 5 6 5
- D) 6 6 6

Pyetja 44.

Një tabelë është:

- A) Grup memorjesh të vazhdueshme që mbajtën të njëjtin tip të dhëne
- B) Grup memorjesh jo të vazhdueshme që mbajtën të njëjtin tip të dhëne
- C) Grup memorjesh të vazhdueshme që mbajtën tipe të ndryshme të dhënash
- D) Grup memorjesh jo të vazhdueshme që mbajtën tipe të ndryshme të dhënash

Pyetja 45.

Është dhënë instruksioni: `f = fopen(filename, "r");`

Duke iu referuar këtij instruksioni tregoni se cili është deklarimi i saktë për variablin f?

- A) FILE f;
- B) float f;
- C) struct FILE f;
- D) FILE *f;

Pyetja 46.

Funksionet push dhe pop kanë lidhje me:

- A) Tabelat
- B) Stivat
- C) Listat
- D) Unionet

Pyetja 47.

Janë dhënë instruksionet e mëposhtme. Tregoni sa do të jetë vlera e a dhe b pas ekzekutimit të këtyre instruksioneve:

```
int a,*b=&a, **c=&b;
a=5;
**c=10;
```

```
*b=**c;  
A) 0 0  
B) 5 10  
C) 10 10  
D) 5 5
```

Pyetja 48.

Nëse `int a[5]` është një tabelë me numra të plotë një dimensionale, tregoni se cili nga instruksionet e mëposhtme i referohet elementit të katërt të tabelës?

- A) `*(a + 3)`
- B) `*(a + 4)`
- C) `a + 3`
- D) `a + 4`

Pyetja 49.

Është dhënë stuktura e mëposhtme:

```
struct nyje {  
    char emri[20];  
    int id;  
    struct nyje *pas;  
};  
struct nyje *kreu = (struct nyje *) NULL;  
Tregoni se çfarë bën funksioni i mëposhtëm.  
void gjej() {  
    if(kreu == NULL || kreu->pas == NULL) return;  
    node *prind = kreu;  
    node *me = kreu->pas;  
    node *femije = me->pas;  
    prind->pas = NULL;  
    while(femije!= NULL){  
        me->pas = parent;  
        parent = me;  
        me = femije;  
        femije = femije ->pas;  
    }  
    kreu = me;  
    kreu->pas = prind;  
}
```

- A) Kthimin mprabsht të listës
- B) Fshirjen e elementit të parë të listës
- C) Futjen e në elementi të quajtur me në listë
- D) Bredhjen e listës

Pyetja 50.

Tregoni sa është vlera e shprehjes `ptr1-ptr2` pas ekzekutimit të instruksioneve të mëposhtme:

```
int tab[]={1,2,3,4,5,6,7,8,9,10};  
int *ptr1=tab+3;  
int *ptr2=tab;
```

- A) 1
- B) 2
- C) 3
- D) 4

ALGORITMIKË

Pyetja 1.

Kompleksiteti i algoritmit të kërkimit linear është:

- A) $O(n)$
- B) $O(n^2)$
- C) $O(\log n)$
- D) $O(n \log n)$

Pyetja 2.

Me renditje kuptohet procesi i _____ të elementeve të një bashkësie të dhënë sipas një _____ të dhënë.

- A) krahasimit algoritmi
- B) përkëmbimit kriteri
- C) krahasimit kriteri
- D) kërkimit algoritmi

Pyetja 3.

Kompleksiteti i algoritmit mergesort është:

- A) $O(n)$
- B) $O(n^2)$
- C) $O(\log n)$
- D) $O(n \log n)$

Pyetja 4.

Është dhënë një tabelë me 10 numra të plotë si më poshtë:

5 3 8 9 1 7 0 2 6 4

Tabela pas iteracionit të parë të lupës së madhe të algoritmit me zgjedhje do të duket:

- A) 2 6 4 0 3 8 9 1 7 5
- B) 2 6 4 9 1 7 0 3 8 5
- C) 0 3 8 9 1 7 5 2 6 4
- D) 0 3 8 2 6 4 9 1 7 5

Pyetja 5.

Tregoni se si është renditja e kompleksiteteve të mëposhtme në rendin rritës:

- A) $O(\log n)$, $O(n \log n)$, $O(n)$, $O(n^3)$
- B) $O(n^3)$, $O(n)$, $O(n \log n)$, $O(\log n)$

- C) $O(\log n)$, $O(n)$, $O(n \log n)$, $O(n^3)$
- D) $O(\log n)$, $O(n^3)$, $O(n)$, $O(n \log n)$

Pyetja 6.

Tregoni deklaratën false rreth pemëve binare.

- A) Çdo pemë binare ka të paktën një nyje.
- B) Çdo nyje ka të shumtën dy fëmijë.
- C) Çdo nyje jo rrënjë ka të paktën një prind.
- D) Çdo pemë jo bosh ka të paktën një rrënjë.

Pyetja 7.

Algoritmi i kërkimit binar nuk është i përshtatshëm të aplikohet në:

- A) Pemët binare të renditura
- B) Listat e lidhura
- C) Tabelat lineare të renditura
- D) Tabelat me shënuesat (pointerat)

Pyetja 8.

Efiçenca e algoritmit matet në terma të:

- A) Kohës së ekzekutimit
- B) Të kohës së kompilimit të programit
- C) Te objekteve që përdoren në program
- D) Të sasisë së variablave të përdorur

Pyetja 9.

Faktori që ndikon në kohën e ekzekutimit

- A) Gjuha e programimit
- B) Kompilatorit të përdorur
- C) Shpejtësia e kompjuterit
- D) Algoritmit të përdorur

Pyetja 10.

Kompleksiteti i kohës kostante shprehet me simbolin:

- A) $O(n)$
- B) $O(\text{cost})$
- C) $O(1)$
- D) $O(a)$

Pyetja 11.

Aksesimi i një elementi të një tabelë është me kompleksitet të kohës:

- A) $O(n)$
- B) $O(1)$
- C) $O(n \log n)$
- D) $O(n^2)$

Pyetja 12.

Futja e një elementi të ri në një tabel është me kompleksitet të kohës:

- A) $O(n)$
- B) $O(1)$
- C) $O(n \log n)$
- D) $O(n^2)$

Pyetja 13.

Fshirja e një elementi në një tabel është me kompleksitet të kohës:

- A) $O(n)$
- B) $O(1)$
- C) $O(n \log n)$
- D) $O(n^2)$

Pyetja 14.

Shtimi i numrave nga 1 deri tek një numër i plotë n është me kompleksitet të kohës:

- A) $O(1)$
- B) $O(n \log n)$
- C) $O(n)$
- D) $O(n^2)$

Pyetja 15.

Tregoni sa është kompleksiteti i kohës për $2n^3 - 10n^2 - n + 6$.

- A) $O(1)$
- B) $O(n)$
- C) $O(n^2)$
- D) $O(n^3)$

Pyetja 16.

Tregoni sa është kompleksiteti i kohës për $n^3 - 234n^{200} - 2^n + 2$.

- A) $O(1)$
- B) $O(n)$
- C) $O(2^n)$
- D) $O(n^3)$

Pyetja 17.

Tregoni sa është kompleksiteti i kohës për $2n^2 \log n + 150n - (n+100)^2$

- A) $O(1)$
- B) $O(n)$
- C) $O(n^2)$
- D) $O(n^2 \log n)$

Pyetja 18.

Për instruksionet e mëposhtme llogarisni kufirin më të lartë:

```

for ( int i = 0; i < n; i++)
{
    counter++;
    for ( int j = 0; j < n; j++)
        counter ++;
}

```

- A) $O(1)$
- B) $O(n)$
- C) $O(n^2)$
- D) $O(n^3)$

Pyetja 19.

Për instruksionet e mëposhtme llogarisni kufirin më të lartë:

```

for ( int i = 0; i < n; i ++ )
    for ( int j = 1; j < n*n; 2*j )
        shuma++;

```

- A) $O(1)$
- B) $O(n \log n)$
- C) $O(n)$
- D) $O(n^2)$

Pyetja 20.

Një algoritëm merr 1ms për madhësi të të dhënave hyrëse $N=100$. Sa kohë do të duhej për $N=1000$ kur koha e ekzekutimit është lineare.

- A) 1ms
- B) 5ms
- C) 10ms
- D) 100ms

Pyetja 21.

Për instruksionet e mëposhtme llogarisni kompleksitetin e kohës:

```

i=1;
while(i<n)
{
    i=i*2;
}

```

- A) $O(\log n)$
- B) $O(n \log n)$
- C) $O(n)$
- D) $O(n^3)$

Pyetja 22.

Për instruksionet e mëposhtme llogarisni kompleksitetin e kohës:

```

int g = 2^n;
int s = 1;
while (g > 1)
{
    h = 1;
    while (h < g)
        {h++;}
    s++;
}

```

- ```
g = g / 2;
}
```
- A)  $O(1)$
  - B)  $O(n \log n)$
  - C)  $O(n)$
  - D)  $O(2^n)$

Pyetja 23.

Cila nga të mëposhtmet përfaqëson kompleksitetin e kohës për algoritmin “merge sort”?

- A)  $O(1)$
- B)  $O(n \log n)$
- C)  $O(n)$
- D)  $O(2^n)$

Pyetja 24.

Çfarë është një algoritëm?

- A) Një diagramë fluksi(flowchart) që përdoret për të zgjidhur problemin.
- B) Një vendimarrje që merret në zgjidhjen e një problemi
- C) Instruksione të përcaktuara hap pas hapi për të zgjidhur një problem
- D) Pseudokodi i programit për zgjidhjen e problemit

Pyetja 25.

Cila është diferenca ndërmjet një diagramë fluksi(flowchart) dhe pseudokodit?

- A) Flowcharti është skematik, ndërsa pseudokodi shkruhet në një gjuhë specifike programimi.
- B) Flowcharti është tekstual, ndërsa pseudokodi ndërtohet në mënyrë skematike.
- C) Asnjë ndryshim mes tyre, pasi flowcharti dhe pseudokodi janë e njëjta gjë.
- D) Flowcharti është përshkrim skematik i algoritmit, ndërsa pseudokodi është përshkrim tekstual i algoritmit.

Pyetja 26.

Në një flowchart instruksionet për hyrje dalje paraqiten nëpërmjet:

- A) Një drethkëndëshi
- B) Një rombi
- C) Një paralelogrami
- D) Një elipsi

Pyetja 27.

Në një flowchart një llogaritje paraqitet nëpërmjet:

- A) Një drethkëndëshi
- B) Një paralelogrami
- C) Një elipsi
- D) Një rombi

Pyetja 28.

Në një flowchart është e nevojshme që të paraqitet një situatë në të cilën të regjistrohen nga tastjera dhe të vendosen në një tabelë 100 numra të plotë. Tregoni çfarë konstrukti do të përdoret?

- A) Vendimarrje
- B) Sekuencë
- C) Iteracione
- D) Proçes

Pyetja 29.

Në një flowchart është e nevojshme që të paraqitet një situatë në të cilën të pasi merret mosha nga përdoruesi afishohet një mesazh i caktuar nëse mosha është nën 18 vjeç dhe një mesazh tjetër nëse mosha është më e madhe se 18 vjeç. Tregoni çfarë konstrukti do të përdoret?

- A) Vendimarrje
- B) Sekuencë
- C) Iteracione
- D) Proçes

Pyetja 30.

Në një flowchart është e nevojshme që të paraqitet një situatë në të cilën të pasi merret emri i përdoruesit i afishohet mesazhi “Përshëndetje ” + emrin e lexuar. Tregoni çfarë konstrukti do të përdoret?

- A) Vendimarrje
- B) Sekuencë
- C) Iteracione
- D) Proçes

Pyetja 31.

Cila nga deklaratat e mëposhtme rreth tabelave dhe listave të lidhura është e vërtetë?

- A) Aksesimi direkt i elementeve duke përdorur indeksat suportohet në të dyja llojet.
- B) Të dyja mund të kërkohen duke përdorur kërkimin binar.
- C) Elementet e të dyja strukturave mund të renditen.
- D) Algoritmi i renditjes është më i shpejtë në tabela se në lista të lidhura.

Pyetja 32.

Konsideroni segment kodin e mëposhtëm:

```
for(int i = 1; i < n; i *= 2) counter++;
```

Kompleksiteti i kohës së ekzekutimit është i rendit:

- A)  $O(n)$
- B)  $O(n^2)$
- C)  $O(n \log n)$
- D)  $O(\log n)$

Pyetja 33.

Në një kërkim të 1000 elementeve, numri maksimal i elementëve të ekzaminuara nga kërkimi linear është \_\_\_\_\_, ndërsa numri maksimal i ekzaminuar nga kërkimi binar është \_\_\_\_\_.

- A) 1000 1000
- B) 1000 10
- C) 10 1000
- D) 100 100

Pyetja 34.

Është dhënë pseudokodi i mëposhtëm:

```
IF x = y
SHKRUAJ x
ELSE
 IF y < z
 SHKRUAJ y
 ELSE
 SHKRUAJ z
ENDIF
ENDIF
```

Nëse vlerat e x,y dhe z janë përkatësisht 2,4,6 çfarë do të afishohej?

- A) 0
- B) 2
- C) 4
- D) 6

Pyetja 35.

Është dhënë pseudokodi i mëposhtëm:

```
count = 1
WHILE count < 5
 WRITE count
 ADD 1 to count
ENDWHILE
WRITE count
```

Çfarë do të afishohet?

- A) 5
- B) 4
- C) 6
- D) 1

Pyetja 36.

Çfarë është sequenca e instruksioneve të sakta për zgjidhjen e një problemi.

- A) Flowchart
- B) Pseudokodi
- C) Programi
- D) Algoritmi

Pyetja 37.

Cila është renditja e pjesëve përbërëse të një algoritmi?

- A) Fillimi, Trupi, Deklarimi, Mbarimi

- B) Fillimi, Deklarimi, Trupi, Mbarimi
- C) Trupi, Fillimi, Deklarimi, Mbarimi
- D) Deklarimi, Trupi, Fillimi, Mbarimi

Pyetja 38.

Printimi i totalit dhe i mesatares janë shembuj të:

- A) Vlerëdhënies
- B) Operacione aritmetike
- C) Operacione të hyrjes
- D) Operacione të daljes

Pyetja 39.

Në flowcharte shenja e diamandit përdoret për të treguar:

- A) Fillimin dhe mbarimit
- B) Hyrjen dhe daljen
- C) Vendimarrjen
- D) Proçesimin

Pyetja 40.

Në flowcharte shenja ovale përdoret për të treguar:

- A) Fillimin dhe mbarimit
- B) Hyrjen dhe daljen
- C) Vendimarrjen
- D) Proçesimin

Pyetja 41.

Mesatarisht, kërkimi linear do të ekzekutojë \_\_\_\_ krahasime në një tabelë me N elemente.

- A) N
- B)  $N/2$
- C)  $N/4$
- D)  $2*N$

Pyetja 42.

Kur një programues forcohet të zgjedhë kërkimin linear ndaj kërkimit binar?

- A) Kur elementet e tabelës janë në rend rritës
- B) Kur elementet e tabelës janë në rend zbritës
- C) Kur elementet në tabelë janë të përnditur
- D) Kërkimi linear nuk është më i mirë se kërkimi binar

Pyetja 43.

Sa është numri mesatar i llogaritjeve që kërkohen në një kërkim binar mbi një tabelë me madhësi 64?

- A) 4
- B) 5

- C) 6
- D) 7

Pyetja 44.

Grada maksimale e çdo kulmi në një graf me  $n$  kulme është:

- A)  $n-1$
- B)  $n$
- C)  $n+1$
- D)  $2*n$

Pyetja 45.

Algoritmi Quick Sort përdor teknikën \_\_\_\_\_.

- A) Programim dinamik
- B) Përça e sundo
- C) Lakmitare
- D) Prapandjekje

Pyetja 46.

Supozoni se një algoritëm përbëhet nga dy kompleksitete të kohës të pavarura nga njëra-tjetra  $f(n)$  dhe  $g(n)$ . Kompleksiteti i algoritmit është i rendit të:

- A)  $f(n) \times g(n)$
- B)  $f(n) + g(n)$
- C)  $\text{Min}(f(n), g(n))$
- D)  $\text{Max}(f(n), g(n))$

Pyetja 47.

Kompleksiteti i shumëzimit të dy matricave të rendit  $m*n$  dhe  $n*p$  është rendit:

- A)  $mnp$
- B)  $mp$
- C)  $mn$
- D)  $np$

Pyetja 48.

Në rastin më të keq Quick Sort ka rend:

- A)  $(n \log n)$
- B)  $O(\log n)$
- C)  $O(n^2)$
- D)  $O(n^3)$

Pyetja 49.

Supozoni se një tabelë me tetë numra të plotë do të renditet duke përdorur një algoritëm renditjeje kuadratik. Pas katër iteracionesh elementet janë të renditura si më poshtë:



2 4 5 7 8 1 3 6

Cila nga deklaratat e mëposhtme është e vërtetë:

- A) Algoritmi mund të jetë me zgjedhje ose me këmbim
- B) Algoritmi mund të jetë me këmbim por jo me zgjedhje
- C) Algoritmi mund të jetë me zgjedhje por jo me këmbim
- D) Algoritmi nuk është as me zgjedhje as me këmbim

Pyetja 50.

Është dhënë tabela me elementët si më poshtë:

23 15 5 12 40 10 7

Pasi aplikohet një herë një algoritëm i caktuar, tabela duket si më poshtë:

15 5 12 23 10 7 40

Gjeni algoritmin që është përdorur.

- A) Quick Sort
- B) Algoritëm me zgjedhje
- C) Merge Sort
- D) Bubble Sort